



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 15.06.2020
Dokument parlamentar

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.12/2018, “PËR
VLERËSIMIN KALIMTAR DHE PERIODIK TË PUNONJËSVE TË POLICISË
SË SHTETIT, GARDËS SË REPUBLIKËS DHE SHËRBIMIT PËR ÇËSHTJET
E BRENDSHME DHE ANKESAT, NË MINISTRINË E BRENDSHME”, TË
NDRYSHUAR””**

Drejtuar: seancës plenare

- *Hyrje*

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 15.06.2020 në parim, nën për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për çështjet e brendshme dhe ankesat, në Ministrinë e Brendshme”, të ndryshuar”*”.

Për të prezantuar projektligjin në komision ishin të pranishëm Zëvendësministri i Brendshëm Z.Julian Hodaj, Drejtori i Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave Z.Muhamet Rrumbullaku si dhe Znj.Ana Kapaj, Kryetare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Relatore për shqyrtimin e projektligjit u caktua deputetja Elona Hoxha (Gjebrea).

- ***Baza kushtetuese e projektligjit***

Projektligji është hartuar përputhje me 81, pika 1 dhe 83 pikat 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë si dhe është në harmoni me legjislacionin në fuqi.

- ***Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e projektligjit***

Qëllimi i këtij projektligji është të japë një kontribut në përmbushjen e objektivit të Qeverisë shqiptare dhe në veçanti të Ministrisë së Brendshme, në krijimin e institucioneve të forta, me profesionistë me integritet.

Vlerësimi i punonjësve, në veçanti i atyre të Policisë së Shtetit, është domosdoshmëri në kuadrin edhe të hapave të hedhura nga Reforma në Drejtësi dhe specifiki të rivlerësimit të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, duke marrë në konsideratë rolin e rëndësishëm dhe përfshirjen e Policisë së Shtetit në hetimet ndaj veprave penale.

Procesi i vlerësimit kalimtar bazohet në problemet e identifikuara nga një analizë e detajuar e situatës aktuale në Policinë e Shtetit, në Gardën e Republikës dhe në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Kjo analizë mundësoi përcaktimin e objektivave specifike, si dhe identifikimin e nevojave për ndryshime ligjore, strukturore dhe procedurale për kryerjen e kontrollit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

Nëpërmjet këtij procesi synohet të garantohet zbatimi i parimit të integritetit, rritja e profesionalizmit dhe garantimi i një karriere të drejtë dhe të bazuar në meritokraci, duke krijuar kështu institucione të forta dhe të besueshme, me profesionistë me integritet.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet që të ulen kostot e procesit, të sigurohet kryerja në kohë e vlerësimit dhe të garantohet një standard uniform vlerësimi pa prekur paanshmërinë, pavarësinë, objektivitetin dhe përputhjen e procesit të vlerësimit me parametrat e procesit të rregullt ligjor.

- ***Diskutimi në komision***

Gjatë prezantimit të projektligjit, Zvendësministri i Brendshëm Zoti Hodaj, u shpreh se ndryshimet në fjalë kanë të bëjnë me dhënien e mundësisë SHÇBA-së, që nëpërmjet trupave të vlerësimit, të vlerësuara me parë sipas një procedure që do të ndiqet me përparësi nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, të kenë të drejtën e shprehur në ligj, **që të ushtrojnë veprimtarinë, paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.**

Me këtë ndryshim synohet shfrytëzimi më i mirë i kohës, në raport me numrin e madh të punonjësve të përcaktuar në ligj, si subjekte rivlerësimi të Shërbimit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesat.

Ndryshimi i dytë, ka të bëjë me heqjen e afatit të veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit.

Zoti Hodaj shtoi se veprimtaria e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, mbaroi në qershor 2020 dhe referuar vlerësimeve aktuale prej 15 subjektesh, në raport me subjektet e përcaktuara për vlerësim, gjykohet se ishte e pamundur që kjo veprimtari të mbyllej brenda afatit të përcaktuar 1 vjeçar si pasojë e ndryshimeve të miratuara me *ligjin nr. 20/2019 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”*.

Ai vuri theksin tek fakti se nga analizimi i veprimtarisë së Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit evidentohen arsye objektive për heqjen e afatit të vlerësimit, si vonesa në marrjen e informacionit nga subjekte të ndryshme, tërmeti i 26 nëntorit 2019 si dhe situata e shkaktuar nga COVID-19.

Mandej fjalën e mori Znj. Ana Kapaj, Kryetare e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit e cila bëri një përmbledhje të punës së kryer deri më tani nga institucioni që ajo drejton.

Në fjalën e saj zonja Kapaj u shpreh si më poshtë:

“Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, ka filluar funksionimin e tij në shkurt të 2019, në përputhje me Ligjin 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, i ndryshuar dhe ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji dhe me përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Qendror të Vlerësimit dhe sekretariatit teknik përkatës.

Me ndryshimet që ligji pësoi në 2019, neni 13 i tij përcakton se “*Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse të punonjësve, sipas nenit 6, të këtij ligji, brenda 1 viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.*”.

Në datë 17 prill 2020, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, ka nisur një kërkesë me argumentimet përkatëse, drejtuar Ministrisë së Brendshme, Komisionit parlamentar për Sigurinë Kombëtare dhe Komisionit parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, ku kërkon shtyrjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Duke filluar nga 25 janar 2020 Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, ka ushtuar aktivitetin si më poshtë:

a) Janë realizuar seancat dëgjimore dhe shpalljet e vendimeve si më poshtë:

1. **Seance Degjimore** datë 05/02/2020 me **Z. Gramos Sako me funksion** Komandant i Gardës së Republikës së Shqipërisë.
2. **Seance Degjimore** datë 05/02/2020 me Z. Gledis Nano, Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
3. **Seance Degjimore** datë 06 /02/2020 me Z. Ardi Veliu me funksion Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
4. **Seance Degjimore** datë 07/02/2020 me **Z. Artan Shkëmbi me funksion** Drejtor i Drejtorisë Hetimore Qëndrore, në Departamentin për Policinë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
5. **Seance Degjimore** datë 10/02/2020 me **Z. Nikoll Rica me funksion** Drejtor i Burimeve Njerëzore në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
6. **Seance Degjimore** datë 12/02/2020 me **Z. Fatos Balla me funksion** Specialist në Sektorin e Hetimit në Drejtorinë e Hetimit të SH.Ç.B.A-së.
7. **Shpallje Vendimi** datë 07/02/2020 për **Z. Gledis Nano me funksion** Drejtor i Drejtorisë së Antiterrorit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
8. **Shpallje Vendimi** datë 07/02/2020 për Z. Ardi Veliu me funksion Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
9. **Shpallje Vendimi** datë 14/02/2020 për Z. Nikoll Rica me funksion Drejtor i Burimeve Njerëzore në Departamentin e Shërbimeve Mbështetëse pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
10. **Shpallje Vendimi** datë 14/02/2020 për Z. Fatos Balla me funksion Specialist në Sektorin e Hetimit në Drejtorinë e Hetimit të SH.Ç.B.A-së.
11. **Seance Degjimore** datë 14/02/2020 me Z. Bujar Zenel Ahmeti Drejtor i Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
12. **Shpallje Vendimi** datë 14/02/2020 për **Z. Bujar Ahmeti me funksion** Drejtor i Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
13. **Seance Degjimore** date 19/02/2020 me Z. Arben Caka me funksion Drejtor i Drejtorisë Rajonale të SHÇBA-së, Tiranë.
14. **Seance Degjimore** datë 21/02/2020 me **Znj. Aida Veizaj (Hajnaj) me funksion Zëvendës** Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
15. **Shpallje Vendimi** datë 21/02/2020 për **Znj. Aida Veizaj (Hajnaj) me funksion Zëvendës** Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
16. **Shpallje Vendimi** datë 28/02/2020 për Z. Artan Shkëmbi me funksion Drejtor i Drejtorisë Hetimore Qëndrore, në Departamentin për Policinë Kriminale pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
17. **Seance Degjimore** datë 04/03/2020 me Z. Arben Dashi, me funksion Drejtor i Drejtorisë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

18. **Shpallje Vendimi** datë 04/03/2020 për Z. Arben Dashi, me funksion Drejtor i Drejtorisë Kundër Krimeve ndaj Personit dhe Pasurisë, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
19. **Seance Degjimore** datë 21 /05/2020 me Z. Sokol Bizhga me funksion Drejtor i Drejtorisë së Forcave Levizëse Operacionale, Departamenti për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
20. **Shpallje Vendimi** datë 22 /05/2020 për Z. Sokol Bizhga me funksion Drejtor i Drejtorisë së Forcave Levizëse Operacionale, Departamenti për Sigurinë Publike, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit.
21. **Seance Degjimore** datë 26/05/2020 me Z. Gramos Sako me funksion Komandant i Gardës së Republikës së Shqipërisë.
22. **Shpallje Vendimi** datë 26/05/2020 për Z. Gramos Sako me funksion Komandant i Gardës së Republikës së Shqipërisë.
23. **Seance Degjimore** datë 29.05.2020 me Z. Bledar Celiku me funksion Drejtor i Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
24. **Seance Degjimore** datë 01.06.2020 me **Z. Lutfi Minxhozi, Drejtor i Drejtorisë për Krimin Ekonomik dhe Financiar, Departamenti i Policisë Kriminale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.**
25. **Shpallje Vendimi** datë 02.06.2020 për Z. Arben Caka me funksion Drejtor i Drejtorisë Rajonale të SHÇBA-së, Tiranë.
26. **Shpallje Vendimi** datë 02.06.2020 për Z. Lutfi Minxhozi, Drejtor i Drejtorisë për Krimin Ekonomik dhe Financiar, Departamenti i Policisë Kriminale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
27. **Seance Degjimore** datë 02.06.2020 me Z. Arben Saliu me funksion Drejtor i Drejtorisë së Standarteve Profesionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
28. **Shpallje Vendimi** datë 02.06.2020 për Z. Arben Saliu me funksion Drejtor i Drejtorisë së Standarteve Profesionale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
29. **Shpallje Vendimi** datë 03.06.2020 për Z. Bledar Celiku me funksion Drejtor i Drejtorisë Kundër Narkotikëve dhe Trafiqeve në Departamentin e Policisë Kriminale, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.

Në mënyrë të përmbledhur Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, nga data 24 Janar ka zhvilluar këto seanca dhe vendime:

Aktiviteti	Numri
Seanca Dëgjimore	15
Seanca shpallje vendimi	14
Seanca në total	29
Publikime vendimimesh	10

Relatorja e projektligjit zonja Hoxha, vuri theksin tek rëndësia e përfundimit të këtij procesi sa më shpejt si një angazhim i marrë nga Qeveria shqiptare. Ajo citoi se këto ndryshime do bëjnë të mundur përfundimin e procesit duke qënë se do t'i jepet mundësi

SHÇBA-së, e cila ka përgjegjësinë e rivlerësimit të një kategorie me të gjerë punonjësish, që të ushtrojë veprimtarinë paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.

Anëtarët e komisionit u shprehën dakort në parim me projektligjin dhe vijuan diskutimet në çështjet që lidhen me përballimin e ngarkesës së punës nga Shërbimi i Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave, cila do ishte koha e mjaftueshme për përmbylljen e këtij procesi, efektet që këto ndryshime do të sjellin në buxhetin e shtetit etj.

Kryetarja e komisionit, bëri një kronologji të ndryshimeve që ka pësuar ligji nga momenti i miratimit të tij në vitin 2018 dhe konkretisht:

Në datën 5 mars të vitit 2018, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin *nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gradës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”*.

Ky ligj është botuar në Fletoren Zyrtare pas nxjerrjes së Dekretit të Presidentit të Republikës, nr. **10747 datë 20.03.2018** dhe ka hyrë në fuqi në **datë 04.04.2018**.

Ligji në fjalë parashikonte që vlerësimi të bëhej sipas një sistemi “kaskadë”, i cili do të kryhej në tri faza, si më poshtë vijon:

Faza e parë: Në këtë fazë, vlerësimi kryhej nga një Komision i Jashtëm Vlerësimi, i cili në përbërje të tij kishte 15 anëtarë, të zgjedhur nga Bordi Përzgjedhës. Komisioni i Jashtëm do të vlerësonte punonjësit që mbajnë grada apo funksione të larta në Policinë e Shtetit, Gardën e Republikës dhe Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, konkretisht, sipas analizës së kryer, 287 punonjës.

Faza e dytë; përfshinte vlerësimin e punonjësve të strukturave objekt të këtij ligji, që mbanin gradat të nivelit mesëm drejtues, konkretisht 2700 punonjës të Policisë së Shtetit dhe 115 nga Garda e Republikës së Shqipërisë.

Gjithashtu, ky komision do të vlerësonte punonjësit e strukturave të veçanta .Në këtë fazë, vlerësimi do të kryhej nga Komisioni Qendror i Vlerësimit, i përbërë nga 45 anëtarë, 15 prej të cilëve ishin anëtarët e Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit, ndërsa 30 anëtarët e tjerë të këtij Komisioni do të përzgjidheshin nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, ndërmjet punonjësve me grada të larta që kanë kaluar me sukses procesin e vlerësimit, në fazën e pare.

Faza e tretë, në mënyrë analoge me dy fazat e para përfshinte vlerësimin e pjesës tjetër të punonjësve të nivelit bazë të strukturave objekt të këtij ligji. Në këtë fazë vlerësimi do të kryhej nga Komisioni Vendor i Vlerësimit i përbërë nga 135 anëtarë (të organizuar në 45 trupa vlerësimi me nga 3 anëtarë secila dhe sekretariati teknik përkatës).

Elementi financiar ka qenë një nga momentet që ka sjellë vonesa në implementimin e këtij ligji.

Ministria e Brendshme, pasi kreu një analizë të thellë, propozoi një mekanizëm të ri për procesin e vettingut të punonjësve të Policisë së Shtetit, por me një kosto shumë herë më të ulët se sa ajo fillestare.

Sipas këtyre ndryshimeve u propozua një mekanizëm i ri për vlerësimin, të cilat në fakt nuk e prekën thelbin e kriterëve të vlerësimit dhe procedurës që do të ndiqej nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit., bazuar në nenin 13 të ligjit nr. 20/2019, datë 28.03.2019 “Për disa ndryshime në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme”, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit do të duhej të ushtronte veprimtarinë e tij deri në përfundimin e procesit të vlerësimit për kategorinë përkatëse sipas nenit 6 të këtij ligji, **brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit.**

Në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 20/2019, datë 28.03.2019 “Për disa ndryshime në ligjin 12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme, Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit, duhet të shqyrtonte rreth 280 subjekte, në kategoritë:

- ✓ Drejtor dhe zëvendës drejtor i përgjithshëm, drejtor departamenti, drejtor i Drejtorisë Qendrore, drejtor e zëvendës drejtor vendor dhe shef komisarati, në Policinë e Shtetit
- ✓ Komandant, zëvendëskomandant dhe kolonel në Gardën e Republikës
- ✓ Gjithë punonjësit në Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat

E gjithë kjo pati një impakt pozitiv në buxhetin e shtetit duke minimizuar kostot shtesë pasi ngarkimi i SHÇBA-së me vlerësimin e punonjësve në fazën e dytë dhe të tretë, pra rreth 12 000 punonjës, i kurseu buxhetit të shtetit rreth 260 milionë lekë.

Ndryshimet e propozuara janë miratuar në seancë plenare në datën 28.03.2019. Më pas Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me Dekretin nr.11175, datë 19.04.2019 ka kthyer ligjin për rishqyrtim në Kuvendin e Shqipërisë.

Në datë 13.05.2019, komisioni përgjegjës ka shqyrtuar Dekretin e Presidentit të Republikës dhe në datën 16.05.2019 është bërë miratimi në seancën plenare dhe ligji ka hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare duke iu hapur kështu rruga për të filluar nga zbatimi real i tij.

Nisur nga problematikat e hasura nga Komisioni i Jashtëm i Vlerësimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë të cilat na janë bërë me dije edhe me shkresën nr. 56 prot., datë 17.04.2020 , Këshilli i Ministrave me **vendimin nr.437, datë 03.06.2020** ka vendosur të propozojë sërish ndryshime, të cilat janë depozituar në Kuvendin e Shqipërisë në datën 04.06.2020 duke ndjekur të gjithë procedurën e parashikuar në Rregulloren e Kuvendit për t’u shqyrtuar me procedurë të përsheptuar.

Këto ndryshime kanë ardhur për arsye objektive, si pasojë e vonesës në shkëmbimin e informacionit me institucione të ndryshme, situatës së krijuar nga tërmeti i 26 nëntorit 2019 dhe së fundmi edhe nga situata e shkaktuar nga COVID-19, situata këto që pezulluan përkohësisht aktivitetin e këtij institucioni.

Projektligji i ri në thelb konsiston në dy çështje kryesore :

- Heqjen e afati për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit, për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gradës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (neni 2 i projektligjit) si dhe:
- Plotësimin e vakumit ligjor, që ka të bëjë me përcaktimin e momenti kur i lind e drejta SHÇBA-së për fillimin e procesit të rivlerësimit për subjektet e përcaktuara në ligj, i cili është parashikuar që të fillojë paralelisht me Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit.

Të dyja këto ndryshime do të ndikojnë në përshpejtimin e këtij procesi ku dhe vetë ligji parashikon tre garanci dhe konkretisht:

E para ka të bëjë me vetë Shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme”.

Misioni i kësaj strukture, referuar nenit 5 të ligjit nr. 70/2014”*Për shërbimin për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Punëve të Brendshme*”, është verifikimi i integritetit dhe pastërtisë së figurës të punonjësve.

Objekt i veprimtarisë së Shërbimit janë:

- a) parandalimi, zbulimi dhe hetimi i veprave penale, si dhe i shkeljeve të ligjit, të kryera nga punonjësit e strukturave gjatë ushtrimit të detyrës dhe për shkak të saj;
- b) inspektimi dhe trajtimi i ankesave ndaj punonjësve të strukturave për mospërbushje të detyrës, sipas standardeve të miratuara me akte normative, për vepra penale dhe shkelje të tjera të ligjit;
- c) ruajtja e integritetit të punonjësve të strukturave;
- ç) verifikimi i pasurisë së punonjësve të veçantë të strukturave, ndaj të cilëve referohen ankesa dhe kallëzime;
- d) analiza, studime dhe rekomandime të përgjithësuara në bazë të inspektimeve dhe hetimeve për aspekte të rëndësishme të organizimit e të funksionimit të strukturave dhe pritshmërisë së publikut në drejtim të sigurisë publike.

Pra keni të bëjmë me një strukturë të konsoliduar që do të ndikojë në shkurtimin e kohës së vlerësimeve individuale, sa kohë që një pjesë e madhe e informacioneve për punonjësit e Policisë apo Gardës gjenden në arkivat e vetë SHÇBA-së si organi i ngarkuar me monitorimin e punës së tyre dhe në veçanti me aspektet e integritetit, pa harruar rolin e vetë SHÇBA-së në proceset e pajisjes me certifikatë sigurie.

Gjatë fjalës së tij Zoti Rrumbullaku, çmoi se e gjithë puna është një garanci për përmbushjen e afatit të marrë nga Qeveria duke shtuar më tej së 1/3 e strukturës së SHÇBA-së është e angazhuar në vlerësimin e kategorive sipas ligjit.

Garancia e dytë parashikohet në nenin 67 të ligjit nr.12/2018 “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat”, të ndryshuar”, ku përcaktohet si më poshtë:

Neni 67
Nënkomisioni

Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Sigurinë Kombëtare në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë krijohet një nënkomision, i cili organizohet dhe funksionon sipas parashikimeve ligjore për nënkomisionet.

Me vendimin nr. 12/2018, Kuvendi i Shqipërisë ngriti nënkomisionin parlamentar “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në ministrinë e Brendshme”, i cili organizohet dhe funksionon në përbërje të Komisionit për Sigurinë Kombëtare .

Objekti dhe fusha e veprimtarisë së këtij nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

Nënkomisioni ka zhvilluar gjithsej 3 mbledhje, për periudhën janar- dhjetor 2019, si dhe një vizitë në institucion në 25 Janar të vitit 2020.

Ky komision në fillimet e veta ka funksionuar vetëm me anëtarët e maxhorancës, sepse ndonëse një pjesë e opozitës kërkoi që ligji të parashikonte ngritjen e këtij nënkomisioni, në qëndrimet e mëvonshme nuk u përfaqësua me asnjë anëtar. Ardhja e opozitës së re në Kuvendin e Shqipërisë, bëri të mundur edhe plotësimin e numrit të këtij nënkomisioni.

Po ashtu, pengesë në ushtrimin e veprimtarisë së komisionit ka qënë edhe mungesa e një mjedisi të përshtatshëm pune për Komisionin e Jashtëm të Vlerësimit si dhe largimi i anëtarëve të përzgjedhur në Sekretariatit Teknik disa prej të cilëve edhe pse janë zgjedhur më pas kanë lënë detyrën. Gjithashtu dorëheqje ka pasur edhe në nivelin e komisionerëve.

Në momente të caktuara puna e këtij nënkomisioni nuk ka qënë e mundur edhe për shkak të kuorumit, sepse një nga anëtarët e këtij nënkomisioni, zoti Pjerin Ndreu, e ka dorëzuar më herët mandatin e deputetit, për t’iu nënshtruar zgjedhjeve lokale. Sidoqoftë, ky nënkomision, duke marrë parasysh të gjithë ecurinë e hyrjes në fuqi dhe zbatimit të ligjit, ka zhvilluar mbledhjen në datën 21 shtator 2018, mbledhje në të cilën është bërë

konsitutumimi i nënkomsionit dhe është zgjedhur sekretari i tij, që është zoti Vorpsi, dhe në datën 1 tetor 2018 me të njëjtin rend dite me rend dite ecuria e procesit të vlerësimit kalimtar.

Po kështu, në datën 6 shkurt të vitit 2019 është zhvilluar e njëjta mbledhje, në të cilën komisioni është njohur me veprimtarinë e Bordit të Përzgjedhjes së anëtarëve të Komisionit të Jashtëm të Vlerësimit dhe anëtarëve të sekretariatit teknik nga periudha e fundit e raportimit.

Garancia e tretë konsiston në faktin se nga tre kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligj, konkretisht, vlerësimi i figurës, pasurisë dhe integritetit, mjafton që njëri nga këto kritere të mos përmbushet automatikisht procedura për këtë subjekt përmbillet.

Komisioni mbas këtij qëndrimi të mbajtur e votoi projektligjin nen për nen dhe në tërësi duke besuar që ndryshimet e bëra në ligj do ndihmojnë që ky proces të kryhet në një kohë optimale.

- ***Përfundim***

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm në mbledhje e miratoi atë duke vlerësuar se:

- ***Në aspektin ligjor***, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.
- ***Në aspektin procedural***, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Relator

Elona HOXHA

Kryetar

Ermonela (Felaj) VALIKAJ